# Udhëzues mbi mënyrat dhe hapat e nënshkrimit elektronik të kërkesave për leje ndërtimi

Në përfundim të aplikimit për leje ndërtimi në portalin e-Albania, te seksioni ñFormulari i aplikimit i nënshkruar elektronikishtò, Aplikuesi ka mundësi të zgjedhë nënshkrimin elektronik me anë të USB nga AKSHI (PKI) ose nënshkrimit me kartë identiteti me Aleat.

## 1. Nënshkrimi me USB - PKI (AKSHI):

Para ngarkimit të dokumentit, Aplikuesi sigurohet që të ketë nënshkruar paraprakisht dokumentin me nenshkrimin elektronik të marrë nga AKSHI, në përputhje me udhëzimet përkatëse (http://akshi.gov.al/images/Manual%20Teknik_Tetor_2016.pdf). Në vijim, Aplikuesi ngarkon dokumentin e nënshkruar elektronikisht dhe klikon butonin ñDërgoò. Me kryerjen e këtij veprimi, aplikimi dërgohet automatikisht në Bashki për shqyrtim dhe përdoruesi njoftohet me email për dërgimin.




*Figura 1: Nënshkrimi me USB te AKSHIT(PKI).*

## 2. Nënshkrimi me kartë identiteti (nga Aleat):

Në rastin e nënshkrimit me kartë identiteti, Aplikuesi pasi informohet tek faqja e Aleat në lidhje me procedurat e nevojshme për kryerjen e kësaj procedure klikon butonin ñDërgoò. Në këtë moment, Aplikuesi ridrejtohet tek faqja e Aleat, së bashku me formularin e aplikimit.




*Figura 2: Nënshkrimi me ane te Aleat*

Pasi sigurohet për saktësinë e përmbajtjes së formularit, Aplikuesi pranon rregullat e vendosura nga Aleat, duke klikuar mbi butonin ñPranoj te nënshkruajò. Në këtë moment, Aplikuesi i shfaqet mundësia e vendosjes se kodit PIN të kartës së identitetit. Pasi vendos PIN dhe klikon butonin ñOKò, kryhen te gjitha verifikimet e nevojshme dhe Aplikuesit i kthehet përgjigja qe formulari u nënshkrua me sukses.




*Figura 3: Ri-drejtimi tek faqja e Aleat së bashku me formularin e panënshkruar.*




*Figura 4: Vendosja e kodit pin*




*Figura 5: Pritja per pergjigjen*

Ne rast se nënshkrimi realizohet me sukses, Aplikuesi ri-drejtohet te aplikimi i tij në e-Albania.




*Figura 6: Nënshkrimi realizohet me sukses*

Kur ri-drejtohet te portali e-Albania, Aplikuesi njoftohet për nënshkrimin me sukses te formularit dhe mund të dërgojë aplikimin duke shtypur butonin ñDergo aplikiminò. Me kryerjen e këtij veprimi, aplikimi dërgohet automatikisht në Bashki për shqyrtim dhe përdoruesi njoftohet me email për dërgimin e aplikimit.




*Figura 6: Dërgimi i aplikimit në bashki*